

Kujdestaria për viktima krimi ndihmon
viktimat e krimit.

Ne nuk jemi autoritet zyrtar.
Ne nuk i tregojmë askujt.
Ndihma jonë nuk kushton asgjë.



Qendra telefonike e Kujdestarive për Viktima Krimi
Kujdestaria Gjithshtetërore për Viktima Krimi
Box 110 14
100 61 Stockholm
Telefoni 0200-21 20 19
Ndihmë gjuhësore 08-642 00 44
telefoncentralen@boj.se
www.boj.se



Është rëndë të jesh viktimë e krimit.
Sikur të gjendesh në një gropë të errët.
Atëherë mbase keni nevojë që dikush t'ju zgjasë dorën.

Telefoni në 0200- 21 20 19
Ose lexoni më shumë në www.boj.se



NDIHMA QË KUJDESTARIA PËR VIKTIMA TË KRIMIT OFRON NUK KUSHTON ASGJË

Kujdestaria Gjithshtetërore për Viktima të Krimit (BOJ) është një organizatë bëmirese joqeveritare që ndihmon njerëzit të cilët kanë pësuar nga krimi. Në gjithë Suedinë kemi mbi 100 kujdestari për viktima të krimit. Kemi kuadra që janë shkolluar pikërisht për të ndihmuar viktima të krimit. Ata ju dëgjojnë, japin këshilla dhe mund të japin informata mbi të drejtat tuaja. Ata poashtu mund t'u japin informata mbi procese gjyqësore. Nëse vie puna që të dilni para gjyqit nuk do të jeni të vetmuar.

Ndihma që ne ofrojmë është falas. Askush tjetër nuk do të merr vesh mbi atë që na tregoni. Të gjithë që punojnë te ne janë betuar të heshtin.

Ne nuk jemi autoritet zyrtar. Ne jemi politikisht dhe konfesionalisht të pavarur. BOJ është një shoqatë që punon në përputhshmëri me të drejtat e njeriut të përcaktuara nga Kombet e Bashkuara.

Kujdestaritë për viktima krimi u ofrojnë ndihmë mbi 40 000 njerëzve që kanë pësuar nga krimet si thyerja e shtëpisë, vjedhja, plaçkitja, keqtrajtimi, kërcënim i kundërligjor, maltretimi, fyerja, aktet seksuale apo dhunimi.

PËRVEÇ SUEDISHTES NE FLASIM EDHE GJUHË TJERA

Kujdestaria Gjithshtetërore për Viktima Krimi ka një qendër telefonimi ku ju mund të drejtoheni për të pyetur, të informoheni ose nëse dëshironi të kontaktoni ndonjë person të kujdestarisë për viktima krimi në afrinë tuaj të cilin ju edhe mund ta takoni.

Nëpërmjet qendrës së telefonimit ju poashtu mund të kontaktoni persona që flasin anglisht, spanisht, frëngjisht, rusisht, persisht, arabisht, në gjuhën sorani, serbokroatisht ose hungarisht.

Ne shpresojmë se në të ardhmen do të mund të ofrojmë ndihmë edhe në më shumë gjuhë.

Nganjëherë mund që dikush nga ndonjë kujdestari lokale, kudoqoftë në Suedi, di të flasë pikërisht në gjuhën tuaj, edhe pse ajo gjuhë ndoshta nuk figuron në gjuhët e sipërpërmendura. Mos hezitoni të na drejtoheni – ne do të mundohemi të gjejmë zgjidhje rreth problemeve gjuhësore.

NË KËTË MËNYRË MUND TË NA KONTAKTONI NË GJUHËN TUAJ

Për ndihmë në spanisht, frëngjisht, rusisht, persisht, arabisht, në gjuhën sorani, serbokroatisht apo hungarisht, telefononi në nr. 08-642 00 44 – Do të dëgjoni përgjigje automatike dhe informata në të gjitha gjuhët e cekura më lart. Leni porosinë dhe thuani gjuhën në të cilën dëshironi t'ju kontaktojmë. Apo telefononi në nr. 0200-21 20 19 dhe dikush do t'u përgjigjet në suedisht apo anglisht.

Nëse dëshironi t'ju kontaktojmë ju poashtu mund të dërgoni një porosi e-maili në adresën kontakt@boj.se. Me atë porosi ju mund të kërkonti që t'ju kontaktojmë në një nga gjuhët në të cilat kemi mundësi për momentin (përveç suedishtes dhe anglishtes); spanisht, frëngjisht, rusisht, persisht, arabisht, në gjuhën sorani, serbokroatisht apo hungarisht.

TË GJITHË VULLNETARËT JANË TË MIRËSEARDHUR TE NE

Ne kërkojmë persona që mund të na ndihmojnë të ofrojmë ndihmë në gjuhë të ndryshme nëpërmjet telefonit apo eventualisht nëpërmjet e-mailit. Nëse keni kohë që të bëheni vullnetar kontakti qendrën telefonike. Kontributi juaj do të jetë i karakterit bëmires dhe për këtë ju nuk do të merrni pagë. Por ne mund t'ju ofrojmë shkollim kualifikues dhe një shoqërim të këndshëm. Kontributi juaj do të jetë i rëndësishëm për viktima krimi që flasin gjuhën tuaj.

Më shumë informata mbi Kujdestarinë e Viktimave të Krimit në suedisht dhe anglisht gjeni në www.boj.se